



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas



Pranuar 03.02 2023			
Nj. Org.	Numër	Shënime	Vlera
13-	052/01-	6578	

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK I DRAFT-RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027



JANAR, 2023

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim në Komunën e të Drenasit, bën njoftimin për :

KONSULTIM

PUBLIK

Për draft rregulloren e menaxhimit të mbeturinave 2023-2027

Me 11.01.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, përkatësisht tek kategoria për konsultimet publike si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook.

1. Publikimi në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/news/njoftim-per-konsultim-publik-per-drat-rregulloren-per-menxhimin-e-mbeturinave/>

2. Publikimi

facebook:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=658225116108751&set=pb.100057638043139.-2207520000.&type=3>

3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41708>



REPUB LIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogoc
Zyra e Kryetarit

Nr. 01-030104-2267 dt: 11/01/2023

Komuna e Drenasit, përmes grupit punues për hartimin e Draft-Rregullore Nr.01/2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Glllogocit (Drenasit), duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë, Komuna e Drenasit/Glllogocit lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft-Rregullore Nr.01/2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Glllogocit (Drenasit)

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 11.01.2023 deri më datën 26.01.2023, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datën 27.01.2023 në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datën 26.01.2023 në ora 16:00 në këto adresa; lumnije.o.krapi@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje për Draft-Rregullore Nr.01/2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Glllogocit (Drenasit), mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, në këtë link:
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/konsultimet-publike-al/>

Platforma për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>

Rrjetin social të Facebook:
<https://www.facebook.com/komunadrenas>



Betim Dobra

Udhëheqës i Zyres për Konsultim me Publikun

Më datë: **27.01.2023** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzat:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/news/njoftim-per-konsultim-publik-per-drat-rregulloren-per-menxhimin-e-mbeturinave/>

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=658225116108751&set=pb.100057638043139.-2207520000.&type=3>

Konsultimi publik filloi në orën 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.



Konsultimin e shpalli të hapur z.Bekim Dobra – Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun. Njoftimi është bërë me kohë 15 ditë përpara dhe ka qenë e publikuar në tri platformat kryesore në platformën e qeverisë (zyrën e Kryeministrit), në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social facebook të Komunës siç janë të përcaktuar në bazë të dispozitave ligjore të cilat procedura se si duhet të bëhet një konsultim publik edhe në bazë të udhëzimit administrativ për Standarde Minimale të Konsultimit Publik me Nr.06/2018 .

Për faktin se dokumenti ende është draft ju mund të jepni komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e juaja në mënyrë që ato të inkorporohen në këtë draft rregullore pasi që ende nuk është miratuar ,sepse që në momentin që miratohet në Kuvendin Komunal atëherë është i zbatueshëm.

Fillimisht fjala i kalohet drejtoreshës së Shërbimeve Publike znj.Lumnije Krapë.



Znj.Krapi falënderoj të gjithë të pranishmit të cilët kanë gjetur kohë të jenë pjesë në konsultimin publik të draft Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, gjithashtu pas këtij prezantimi të këtij draft dokumenti, ndjehuni të lirë dhe mirëpresim çdo koment, sugjerim të vlefshëm që mund të inkorporojmë në draft Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave para se të shkohet në Kuvend Komunal për miratim. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për

menaxhimin e mbeturinave, hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e Komunës së Glllogocit, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Në Këtë Rregullore janë 11 kapituj qe përmbajnë - 45 nene, të cilat po i laboroj në vazhdim :

Kapitulli i I-rë parasheh Dispozitat e përgjithshme të Rregullores dhe përmban 3 nene;

- Neni 1 - sqaron qëllimin e Rregullores;
- Neni 2 – sqaron fushëveprimin dhe
- Neni 3 – sqaron përkufizimet që janë të përdorura në këtë Rregullore .

Kapitulli i II-të, parashihet Sistemin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 4 - sqaron parimet për Menaxhimin e mbeturinave;
- Neni 5- sqaron organizimin e Menaxhimit të Mbeturinave;
- Neni 6 -sqaron Reduktimin, Ripërdorimin dhe Riciklimin e mbeturinave dhe
- Neni 7-sqaron Trajtimin e barabartë të konsumatorëve, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave ne territorin e Komunës së Drenasit.

Kapitulli i III-të sqaron procedurat për planifikim të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave të cilat janë të specifikuara nëpër këto nene :

- Neni 8 sqaron dokumentet e nevojshme për planifikimin dhe Menaxhimin e Mbeturinave;

- Neni 9 sqaron periudhën kohore të validitetit të Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave;
- Neni 10 sqaron masat për parandalimin e krijimit të mbeturinave tek gjeneruesit e mbeturinave dhe
- Neni 11 sqaron masat për zbatimin PKMM në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Kapitulli i IV-të parasheh Detyrat dhe përgjegjësitë për Menaxhimin e Mbeturinave për zyrtarin për Menaxhim të mbeturinave në nivelin Komunal dhe përmban këto nene:

- Neni 12 sqaron rolin e Zyrtarit për Menaxhimin e Mbeturinave në kuadër të drejtorisë përkatëse (ZMM);
- Neni 13 tregon detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Neni 14 sqaron të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave;
- Neni 15 sqaron detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave;

Kapitulli i V-të, parasheh Aktivitetet për Menaxhimin e Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 16 sqaron mënyrën e grumbullimit të mbeturinave;
- Neni 17 sqaron orarin e itinerarit për hedhjen dhe mbledhjen e mbeturinave;
- Neni 18 sqaron mënyrën e deponimit dhe të transportimit të mbeturinave të operatorit ekonomik dhe
- Neni 19 sqaron vendin ose lokacionin e Deponive të mbeturinave ku në këtë rast bëhet fjalë vetëm për deponitë të cilat janë të licensuar nga organet kompetente.

Kapitulli i VI-të, parashihet mënyrën e zgjedhjes së Operatorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 20 sqaron zgjedhjen e Operatorit për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Neni 21 sqaron shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Impianteve dhe objekteve për Menaxhimin e Mbeturinave dhe
- Neni 22 specifikon Kontratën me operatorin;

Kapitulli i VII-të, parashihet Kategorizimin e konsumatorëve dhe tarifat për shërbimet e Menaxhimit të Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 23 parasheh Kategorizimin e konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave dhe
- Neni 24 sqaron mënyrën e faturimit të mbeturinave.

Kapitulli i VIII-të, parasheh Informimin, promovimin dhe raportin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 25 sqaron organizimin e Seancave vjetore për çështjet e Menaxhimit të Mbeturinave;
- Neni 26 tregon për organizimin e mbajtjes së Ditëve për mjedis të pastër;

- Neni 27 sqaron mënyrën e Informimit, promovimit dhe ngritjes së vetëdijes për Menaxhimin e Mbeturinave dhe
- Neni 28 sqaron mënyrën e Raportimit vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave;

Kapitulli i IX-të parasheh Bashkëpunimin në nivel Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe përmban këto nene:

- Neni 29 sqaron bashkëpunimin në nivelin Komunal të njësive përbërëse të Komunës dhe Administratës Komunale për mënyrën e zbatimit të PKMM-së për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Neni 30 parasheh bashkëpunimin ndër-komunal në fushën e Menaxhimit të Mbeturinave, kur është një interes publik në mes të dy apo më shumë Komunave dhe
- Neni 31 sqaron bashkëpunimin ndërmjet konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile;

Kapitulli i X-të parasheh Mbikëqyrjet Inspektive dhe Kundërvajtjet dhe përmban këto nene:

- Neni 32 sqaron në 5 pika Mbikëqyrjen inspektive të Menaxhimit të Mbeturinave dhe rolin e inspektorit Komunal për këtë qëllim;
- Neni 33 sqaron Kundërvajtjet dhe veprat penale që shkaktohen nga gjeneruesit e Mbeturinave qoftë ata persona fizikë apo persona juridik;
- Neni 34 sqaron mënyrat e Procedurës së ankesës në pajtim me Ligjin në fuqi 05/L-031 të procedurës së përgjithshme Administrative dhe
- Neni 35 sqaron mënyrën e trajtimit të Mbeturinave që hedhen nga persona të pa njohur.

Kapitulli i XI -të parasheh Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe përmban këto nene:

- Neni 36 sqaron mbajtjen Përgjegjësisë individuale për personat fizikë dhe juridik për veprimet ose mos veprimet e tyre që kanë bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave ligjore ;
- Neni 37 sqaron mënyrat e Procedurat përmbarimore dhe gjyqësore ndaj konsumatorëve që nuk paguajnë mbeturinat;
- Neni 38 sqaron mënyrën e buxhetimit dhe financimit të Menaxhimit të Mbeturinave;
- Neni 39 parasheh mënyrën e përgatitjes së Regjistrit të deponive ilegale ;
- Neni 40 parasheh ngritjen e kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave të gjithë punonjësve të Komunës e në veçanti punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e MM-së.
- Neni 41 sqaron rolin mënyrë së Zbatimit të kësaj rregulloreje dhe përfshin ZMM, Operatorët e angazhuar dhe të gjithë personat fizike dhe juridik;
- Neni 42 sqaron mënyrën e Interpretimit ligjor brenda kuadrit Kushtetues ;
- Neni 43 sqaron mënyrën e Shfuqizimit të Rregullores së më hershme
- Neni 44 sqaron mënyrën e Publikimit në faqe të Komunës dhe

- Neni 45 sqaron mënyrën e Hyrjes në fuqi të Rregullores.

Pas përmbylljes së perceptimit nga drejtoresha znj. Lumnije krap, atëherë z.Dobra hapi debat lidhur me propozimet dhe komentet që kanë qytetarët lidhur me draft Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave:

Hapim debatin për këtë dokument dhe kushdo që ka ndonjë koment apo edhe sugjerim ta marrë fjalën.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, anëtarët e grupit punues do t'i trajtojnë me kujdes dhe më pastaj do të vendosin nëse do t'i inkuadrojnë në dokumentin final.



Arben Shala – Përshëndetje për të gjithë, ju faleminderit për ftesën, në kuadër të diskutimit për draft rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave kërkojë që të bëhet ndarja e mbeturinave në burim.

Ksamil Ramadani- shtroi pyetjen se a e ka paraparë rregullorja çmimin si dhe a janë çmimet e njëjta si për biznese si për ekonomi familjare.

Pas dëgjimit së kërkesave të qytetarëve dhe kërkesave të tyre , u dhanë edhe përgjigjet nga drejtoresha e Shërbimeve Publike znj.Lumnije Krap në këtë rast drejtoresha theksoi se te gjitha shqetesimet e ngritura nga ana juaj jane te arsyeshme dhe do të merren në konsideratë, sa i

përket shqetësimit për ndarjen e mbeturinave ne burim ju vëmë në dijeni se ky procesi ka filluar para katër viteve si pilot project ne pikat grumbulluese te mbeturinave ne qendër te qytetit si dhe Çikatovë të vjetër, në Institucione shkollore po ashtu ky proces është zgjeruar edhe në Drenas II, Poklek i ri dhe në Lagjen e re në Komoran . Ky proces për momentin është ndërpre për shkak të mungesës së mekanizmit adekuat të KRM ‘‘Pastrimi’’ mirëpo pritët që ky proces të vazhdoj në këtë vit dhe vitet e ardhshme, sepse këto janë të parapara edhe në PKMM dhe në Rregulloren Komunale te Menaxhimit të Mbeturinave.

Ndërsa sa i përket tarifave për grumbullimin e mbeturinave që u parashtrua si pyetje , theksoi se këto janë tarifa që janë caktuar me Rregulloren Komunale për plotësim ndryshim për taksat, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, mirë po të njëjtat çmime janë edhe në shtojcën e kësaj rregulloreje Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave ,ku janë të paraqitura çmimet të cilat ndryshojnë për ekonomi familjare për biznese dhe institucione.

Takimin e mbylli udhëheqësi i takimit me publikun, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe për angazhimin në këtë tubim.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 12:00

Përpiloi : Vlora Zuçaku Morina



Janar, 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit

01 Nr. 020-17204 dt. 26.04.2021

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.031/L-040 , nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit , Nr.04/L-060 për Mbeturina, nenit 72 pika 72.1 nën (h) të Statutit të Komunës së Drenasit, kryetari i komunës nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për formimin e Grupit punues për hartimin dhe plotësim ndryshimin e Planit komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Drenasit me nr.12-501-13817 i dt. 16.03.2016- (2016-2021).

I

Grupi punues është në përberje:

1. Lumnije Krapit- koordinatorë e grupit,
2. Adhurim Hoxha- Kyesues i grupit, DSHPE
3. Afrim Prokshi, anëtarë, DSHPE
4. Ibrahim Hajdari , anëtarë, DSHPE
5. Hazir Elshani, anëtarë, DKA
6. Albulena Hetemi-Lushtaku, anëtarë, DSHMS
7. Granit Karaqica, anëtarë, Drejtoria e Infrastrukturës,
8. Besart Bajrami, anëtarë, DPUMM
9. Nexhmije Korrumeli, anëtarë, DF
10. Shehrije Mustafa, anëtarë, DEZH
11. Haki Bekolli, anëtarë, Drejtoria e Inspeksionit,
12. Artan Rama, anëtarë, KRM "Pastrimi"
13. Arben Nika, anëtarë, OJQ

II

Në hartimin e këtij PKMM, na mbështet edhe GIZ-i me këshilla, rekomandime dhe staf profesional dhe takimet me ta do të mbahen vetëm në mënyrë virtuale.

III

Detyrë e grupit punues është që të bëjë hartimin dhe plotësim ndryshimet e nevojshme të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Drenasit, duke përfshirë masat, objektivat dhe aktivitetet e nevojshme, për realizimin sa më të suksesshëm të menaxhimit të mbeturinave.

IV

Pas hartimin dhe plotësim ndryshimit të PKMM, grupi punues i propozon Kryetarit të komunës miratimin e Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave në Kuvendin e komunës, dhe i cili do të ketë vlefshmëri në periudhën kohore prej 5 vitesh (2021-2026)

V

Ky Vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit të Kryetarit të komunës.

Ky vendimi i dorëzohet:

Zyrës së kryetarit,

Anëtarëve të grupit punues,

Arkivës së komunës

 Kryetar i komunës
[Signature]
Lladrovci

Më dt: 27/01/2023

Drenas





Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Rregulloren Komunale të menaxhimit të mbeturinave

	Emri Mbiemri	Vendi	Nr. I telefonit	Nënshkrimi
1	FITIM GASHI	LLAPUSHNIK	044/303/902	
21	HAXHI ZARIQI	BAJCE	049/456/182	
3	Nejseme Morina	Gjitarovë Vjetër	014-465-164	
4	Florian Mulaj	Tërstenik	049-226-365	
5	Shaliti Shala	VUÇAK	044-277-480	
6	Iskender Hoxha	DRENOS	044-175-597	
7	Ilir Morina	DSHPE	044-424-099	
8	Arif Berishti	DRENOS	044-599-108	
9	FATLINDA ZYMBERI	PORLEK RI	049-929-932	
10	SHKENDIJE THAQI	LLAPUSHNIK	049-427-168	
11	Florian Hasi	Gjillogoc	044-666-482	
12	Leonora Shala	VUÇAK	049-523-096	
13	Ilir (Hoxha)	Gjitarovë	043-883-317	
14	Qendrim Gjareci	Verbos	049-629-311	
15	Sejdi Kozhani	DSHPE	044-303, 099	
16	Lumijete Topi	DSHPE	049 978-444	
17	Arif Shala	Arif	049-164 522	
18	Behim Dobri	Drenos	049 978 755	
19	Arif Veli	Manaj, ZIKI	049/826-460	
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				

Më dt: 27/01/2023

Drenas

Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Rregulloren Komunale të menaxhimit të mbeturinave

	Emri Mbiemri	Vendi	Nr. I telefonit	Nënshkrimi
1	LIRIDONA DUKI	DIP	049 977882	
21	ANTIGONA DUKI	ISITRE	049-181-526	
3	MAJLINDA GASHI	DIP	043-799-988	
4	FLUIDA NIKA	DBF	049-312-123	
5	Lardie Mustiu	DBF		
6	KUSHTRIM BERISHA	DIP	049	
7	Mensur Gjokaj	DIP	044-502-087	
8	Arben Velici	CEDE	044-383-954	
9	Krenar Nika	CEDE	049978703	
10	SHABAN DORBA	DPUMM	049 977-796	
11	Aurela Gjoshi	Drenas	045-497-750	
12	BCSART BAKRAN	DPUMM	049 977 876	
13	Ksami Jamar	DZHE	044-558632	
14	Arben Slob	DK	048-164-522	
15	Bekim Dobro	Drenas	049 977 799	
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				